



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

VENDIM

Nr. 478, datë 31.07.2024

**PËR
TRANSFERIMIN E PËRKOHSHËM TË GJYQTARES
{...} NË GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM TIRANË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetur në nenin 46 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në vendimin nr. 23, datë 07.02.2019 të KLGJ-së “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit” i ndryshuar, në vendimin nr. 433 datë 31.07.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe duke mbajtur në konsideratë dhënien e pëlqimit të gjyqtares {...} me komunikimin elektronik, datë 31.07.2024, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

VENDOSI:

1. Transferimin e përkohshëm me pëlqim të gjyqtares znj. {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një periudhë deri në një vit, që mund të ndërpritet në rast të ndryshimit të rrethanave që kushtëzuan transferimin.
2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 11.09.2024.
3. Gjyqtarja {...} përjashtohet menjëherë nga procedurat e ndarjes së çështjeve gjyqësore në gjykatën ku ka caktimin e përhershëm, Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.
4. Gjyqtarja {...} ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet gjyqësore që ka në gjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, që ndodhen në fazën e konkluzioneve përfundimtare, çështjet civile që ndodhen në seancë gjyqësore dhe çështjet penale me të pandehur që ndodhen nën masën e sigurimit ”arrest në burg” dhe “arrest në shtëpi” për të cilat ka filluar shqyrtimi gjyqësor.

5. Ngarkohet zv. Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për përcaktimin e numrit dhe të rrethit të çështjeve që do të rindahen me short, me qëllim që ngarkesa e punës së gjyqtarës {...}, për aq sa është e mundur, të jetë jo më të lartë se numri mesatar i çështjeve për gjyqtar të asaj gjykatë, duke marrë në konsideratë ngarkesën në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë dhe Tiranë, si dhe të përfshijë çështje të të gjitha kategorive dhe të së njëjtës vjetërsi sipas kohës së regjistrimit të tyre, për të cilat nuk janë kryer veprime apo shpallur për gjykim nga gjyqtarët relatorë.
6. Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
7. Një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR